

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EAGLE NEST CORPORATION”**

Në Tiranë, sot më datë 27/5 2021, Meriton Mjekiqi, i lindur më 23.05.1995 në Waiblingen, Republika Federale e Gjermanisë, madhor me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me kartën e identitetit me numër ID0955824 dhe numër personal 1234598437, me banim në Prishtinë, Republika e Kosovës dhe Faton Hajrizaj, i lindur më 29.07.1985 në Budisalc, Klinë, Republika e Kosovës, madhor me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me pasaportën me numër 542299812, me banim Londër, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut, në cilësinë e ortakëve themelues, redaktuan këtë akt themelimi, përmes të cilit deklarojnë se me vullnet të lirë dhe të pavesuar, mbështetur në Kushtetutë e Republikës së Shqipërisë dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në ligjin për QKR, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin “EAGLE NEST CORPORATION” SH.P.K.

**KREU I
EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1
Emri**

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “EAGLE NEST CORPORATION” SH.P.K.

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Prodhimi, riprodhimi dhe shpërndarja në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj, komunikimi në publik përmes përcjelljes në publik, përmes paraqitjes publike, përmes transmetimit dhe ritransmetimit, përmes vendosjes në dispozicion të publikut, përmes përcjelljes në publik me anë të internetit, vendosjes në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese, shfrytëzimi në mënyrë digjitale në internet me anë të vënies në dispozicion të publikut nëpërmjet shpërndarjes në mënyrë digjitale përmes shitjes me anë të shkarkimeve dhe me anë të streaming, shfrytëzimi në mënyrë digjitale në internet me anë të monetizimit në platformën “YouTube” si dhe në platformat e ngjashme me platformën “YouTube” i veprave audiovizuale, të cilat përfshijnë filmat kinematografikë, filmat televizivë, filmat e animuar, reklamat ose filmat e tjere, videot e shkurtëra muzikore, dokumentarët, emisionet televizive dhe grafikate televizive si dhe veprat e tjera audiovizuale të shprehura nga sekuenca të pamjeve lëvizëse të ndërlydhura, me ose pa zë pavarësisht nga natyra e mjetit në të cilën ato janë të fiksuara.

Prodhimi i fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; riprodhimi i fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; shpërndarja e fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; qiradhënia e fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; huadhënia publike e fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; ritransmetimi kabllor dhe autorizimi i ritransmetimit kabllor të fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; vënia në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese të fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; shfrytëzimi në mënyrë digjitale në internet me anë të vënies në dispozicion të publikut nëpërmjet shpërndarjes në mënyrë digjitale përmes shitjes me anë të shkarkimeve dhe me anë të streaming të fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; shfrytëzimi në mënyrë digjitale në internet me anë të monetizimit në platformën “YouTube” si dhe në platformat e ngjashme me platformën “YouTube” të fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës, si pjesë përbërëse e veprave audiovizuale.



Blerja dhe shitja nëpërmjet kalimit në formë ekskluzive ose jo ekskluzive të të drejtave pasurore të kompozimeve muzikore me ose pa tekst, të të drejtave pasurore të krijimeve të fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore si dhe çdo krijim tjetër me gojë ose me shkrim, të lajmeve si dhe të informacioneve të shtypit që kanë karakter të thjeshtë informimi.

Shfrytëzimi i kompozimeve muzikore me ose pa tekst përmes riprodhimit, shpërndarjes, qiradhënies, komunikimit në publik, huadhënies publike, përshtatjes, aranzhimit muzikor si dhe çdo transformimi tjetër, vënies në dispozicion të publikut në mënyrë digjitale në internet me anë të shkarkimeve, me anë të streaming, me anë të monetizimit.

Shfrytëzimi i krijimeve të fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore si dhe të çdo krijimi tjetër me gojë ose me shkrim, të lajmeve si dhe të informacioneve të shtypit që kanë karakter të thjeshtë informimi përmes riprodhimit, shpërndarjes, qiradhënies, komunikimit në publik, huadhënies publike, përshtatjes, përkthimit si dhe çdo transformimi tjetër, vënies në dispozicion të publikut në mënyrë digjitale me anë të shkarkimeve, me anë të streaming, me anë të monetizimit.

Blerja dhe shitja përmes kalimit në formë ekskluzive ose jo ekskluzive të të drejtave pasurore të interpretimit dhe/ose ekzekutimit të artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues të aktorëve, këngëtarëve, muzikantëve, valltarëve dhe personave të tjerë, të cilët paraqesin, aktrojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë, ekzekutojnë, ose që shfaqin në mënyra të tjera vepra letrare dhe artistike, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë format e shprehjes së folklorit, varietete, shfaqjet e cirkut ose shfaqjet me kukulla.

Drejtimi, zhvillimi, udhëheqja dhe mbrojtja e karrierës artistike profesionale e artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues, në të cilët përfshihen aktorët, këngëtarët, muzikantët, valltarët dhe personat e tjerë, të cilët paraqesin, aktrojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë, ekzekutojnë, ose që shfaqin në mënyra të tjera vepra letrare dhe artistike, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë format e shprehjes së folklorit, varietete, shfaqjet e cirkut ose shfaqjet me kukulla.

Organizimi, prodhimi i veprimtarive artistike të çdo lloji, përfshirë koncertet muzikore të çdo lloji.

Botimi, prodhimi, riprodhimi dhe shpërndarja e revistave, gazetave, e krijimeve të fjalës të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore si dhe të çdo krijimi tjetër me shkrim. Komunikimi në publik përmes shfaqjes publike në faqet e internetit të krijimeve të fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore, të çdo krijimi tjetër me gojë ose me shkrim, të lajmeve si dhe të informacioneve të shtypit që kanë karakter të thjeshtë informimi.

Prodhimi, shpërndarja, komunikimi në publik i krijimeve fotografike, duke përfshirë veprat fotografike si dhe të çdo krijimi tjetër që shprehet nga çdo proces i ngjashëm me atë fotografik.

Krijimi i faqeve të internetit, mirëmbajtja dhe tregtimi i faqeve të internetit.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pakufizuar

Neni 4 Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:

Mak Albania Hotel, ish – Hotel Sheraton, Sheshi “Italia”, Tiranë, 1001, Republika e Shqipërisë.

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000.00 (njëqindmijë) Lekë.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:
 - Ortaku themelues Meriton Mjekiqi është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 49,000.00 (dyzetëenëntmijë) Lekë, që përben 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - Ortaku themelues Faton Hajrizaj është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme

- 51,000.00 (pesëdhjetëenjëmijë) Lekë, që përbën 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6 **Transferimi i kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

Neni 7 **Organi Vendimmarrës**

1. Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.
3. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e percaktuara në shkronjat "g" dhe "h" të pikes 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
5. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
6. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një



ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 8

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori ose nga administratorët e shoqërisë apo nga ortakët e pakicës.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
4. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni 9

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statudit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështjet e tjera të renditura në nenin 7 të këtij akti themelimi.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", vlefshmëria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 11

Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një



4

shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Shoqëria administrohet nga një administrator:

Meriton Mjekiqi, i lindur më 23.05.1995 në Waiblingen, Republika Federale e Gjermanisë, madhor me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me kartën e identitetit me numër ID0955824 dhe numër personal 1234598437, me banim në Prishtinë, Republika e Kosovës, i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Neni 12

Kompetencat e Administratorit

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë;
 - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe në këtë statut.
2. Administratori është i detyruar të therasë asamblene e përgjithshme, në rastet kur:
 - a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 13

Përgjegjësitë e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja e përgjithshme, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 3 e 4 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.
7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 14 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor. Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiare, asambleja e përgjithshme mmiraton bilancin e paraqitur nga administrator. Asambleja e përgjithshme vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç parashikohet nga ligji.

KREU V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 15 Prishja e shoqërisë dhe likuidimi

1. Shoqëria prishet:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;
2. Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".



3. Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortaket.
4. Nëse ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 16

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 17

Baza Ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plotë me statutin e shoqërisë dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në statutin e shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e statutit të shoqërisë, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"EAGLE NEST CORPORATION"

Meriton Mjekiqi



Meriton Mjekiqi

Faton Hajrizaj

